



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 06
Prishtinë, më 25 mars 2011

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 25 MARS 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari - E deklaroi të hapur mbledhjen plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 94 deputetë. I njoftoi të papranishmit se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

Për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Halit Krasniqi - Diskutoi në lidhje me arrestimet e fundit ndaj pjesëtarëve të Brigadës 121 të UÇK-së. Tha se pjesëtarët e kësaj brigade nuk i kanë shkelur asnjëherë ligjet e luftës, por e kanë mbrojtur masën e popullit prej 85 mijë vetave, të vendosur në Malet e Berishës.

Sabri Hamiti - Insistoi të respektohet Rregullorja e Kuvendit, ngase Kryesia në mbledhje të përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare ka vendosur që në mbledhjen e sotme plenare të mos përfshihet pika për deklarimet e deputetëve.

Gëzim Mehmeti diskutoi për vijën kufitare të Republikës së Kosovës me Malin e Zi, dhe i ngriti shqetësimet rreth ndërhyrjeve të autoriteteve të Malit të Zi në territorin e Kosovës. Kërkoj që kjo çështje të adresohet sa më parë.

Liburn Aliu - Diskutoi për arrestimin e ushtarëve të UÇK-së, për fletarrestin ndaj deputetit Fatmir Limaj dhe për pasojat të këtyre ngjarjeve. Shtoi se duhet t'i kundërvihemi Pakos së Ahtisarit dhe ta ndryshojmë Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse pasojat do të jenë të vazhdueshme.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011 dhe
3. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Komisionin Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme

Arsim Bajrami – Vuri në pah se në procesverbalin e 10 marsit 2011, në vendimin e Komisionit për Legjislacion, është shënuar emri i tij si zëvendëskryesues i parë i këtij Komisionit. Deklaroi se nuk dëshiron të jetë nënkryetar i këtij Komisioni, por vetëm anëtar. Këtë e arsyetoi se, me rastin e caktimit të kryesuesve të komisioneve parlamentare, nuk është marrë për bazë ana profesionale.

Visar Ymeri - Theksoi se procesverbali i mbledhjes plenare, i datës 7 mars 2011, nuk i pasqyron në tërësi diskutimet nga kjo mbledhje.

Kryetari - Sqaroi se në procesverbal jepen vetëm çështjet që diskutohen, përmbledhja e diskutimeve, rezultatet e votimit dhe vendimmarrja, ndërsa diskutimet e plota jepen në trnaskript.

Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 7 dhe 10 mars 2011.

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011

Kryetari – E ftoi kryeministrin, Hashim Thaçi, që në emër të Qeverisë ta prezantojë këtë projektligj.

Hashim Thaçi - Fillimisht shfaqti kënaqësinë që e prezanton para Kuvendit Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011, dhe shprehu besimin se deputetët tashmë e kanë lexuar këtë Projektligj dhe i kanë krijuar opinionet e tyre për të. Tha se në këtë Projektligj kanë punuar bashkërisht ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, që i kanë

trajtuar kërkesat buxhetore në mënyrën më të mirë të mundshme. Gjithashtu kryeministri i falënderoi grupet parlamentare, para të cilave ministri i Financave i ka dhënë sqarimet e duhura për Projektligjin.

Më tej kryeministri tha se zhvillimet politike në fund të vitit të kaluar kushtëzuan që Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011, ta paraqesin në Kuvend në muajin mars të këtij viti. Projektbuxheti për vitin 2011 është diskutuar hollësisht me ekspertë të Komisionit Evropian dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar, me të cilët pjesa më e madhe e qëndrimeve janë harmonizuar. Sqaroi për partneritetin e krijuar ndërmjet Qeverisë Republikës së Kosovës, nga njëra anë, dhe të institucioneve ndërkombëtare dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar, nga ana tjetër.

I sqaroi edhe disa nga parametrat, që janë paraqitur në Projektligj, e që kanë të bëjnë me: rritjen ekonomike reale për vitin 2011, që parashihet të jetë 5,3%, përderisa në vitin e kaluar ajo ishte 4%, të hyrat parashihet të jenë më të larta 12% në krahasim me ato të vitit paraprak, por edhe shpenzimet do të jenë më të larta, si shkak i punimeve infrastrukturore në vend dhe në autostradën Morinë – Merdare.

Kryeministri Thaçi shtoi se për kategorinë e pagave parashihet rritje për të punësuarit në arsim, në polici, në administratë, në shëndetësi, për familjet e dëshmorëve dhe të invalidëve të luftës, për zjarrfikësit dhe për minatorët, gjithnjë sipas vendimeve shtetërore, që i ka marrë Qeveria e Republikës së Kosovës para pak kohësh. Gjithashtu sqaroi se me këtë Projektligj janë paraparë mjetet financiare për rritjen e pensioneve, në ndërkohë që pritet të procedohet dhe të shqyrtohet në Kuvend, sa më shpejt që është e mundur, Projektligji për Skemën Pensionale.

Kryeministri, duke iu referuar vendimit për rritje pagash për kategoritë e lartpërmendura, tha se ky ka qenë një nga vendimet e tij më të vështira, por këtë vendim duhet parë në kontekst të zhvillimeve ekonomike në vend, siç janë: papunësia e madhe, niveli i deritanishëm i pagave, standardi i ulët i jetesës, etj. Me rritjen, që do të ndodhë pas miratimit të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011, pritet të ndryshojë për të mirë mirëqenia e qytetarëve, por do të përmirësohet dukshëm edhe cilësia i shërbimeve të ofruara.

Në fund, kryeministri i ftoi deputetët për debat konstruktiv në dobi të interesave të qytetarëve dhe të shtetit dhe pa dallim partiak ta votojnë Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011.

Kryetari – E ftoi ministrin e Financave që në emër të Qeverisë ta arsyetojë këtë Projektligj.

Bedri Hamza – ministër – I falënderoi të gjitha grupet parlamentare me të cilat kanë mbajtur takime për t'i diskutuar në mënyrë profesionale çështjet që ndërlidhen me Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011.

Në vazhdim ministri u përqendrua në katër aspekte të rëndësishme të këtij Projektligji:

1. Aspektet ligjore dhe procedurale,
2. Aspektet ekonomike,
3. Struktura e projektligjit,
4. Relacionet me institucionet ndërkombëtare.

Në lidhje me aspektet ligjore të përgatitjes së Projektligjit tha se janë bërë brenda Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësisë, ndërkaq procedimi i tanishëm i këtij Projektligji është pasojë e situatës politike, që mbizotëroi muajve të fundit.

Sa u përket operacioneve buxhetore për këta muajt e fundit, ministri tha se kanë qenë në pajtim me nenin 24 të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësisë. Një pjesë të diskutimit të tij lidhur me këtë aspekt ai ia kushtoi edhe dimensionit të

transparencës, për të cilin tha se çdo qytetar ka mundësi që raportet e shpenzimeve buxhetore t'i përcjellë nëpërmjet faqes elektronike të Ministrisë që ai e drejton.

Në lidhje me aspektet ekonomike ministri theksoi se sipas të dhënave të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, bruto prodhimi vendor në vitin 2010 është rritur mbi 4%, ndërsa mbulueshmëria e importit nga eksporti është rritur për 14%.

Për vitin 2011, tha se rritja reale parashihet të jetë 5.1%, që pritet të jetë si rezultat i rritjes së eksportit, të konsumit dhe të investimeve, ndërkaq në rritjen e konsumit do të ndikojë rritja e pagave në sektorin publik. Po ashtu parashihet rritja e investimeve kapitale, që do të arrijnë në kuotën e 572 milionë €, ndërsa çmimet e konsumit, si pasojë e zhvillimeve ekonomike ndërkombëtare, parashihet të rriten për 5.3%, gjatë vitit 2011.

Në lidhje me strukturën e Projektbuxhetit, tha ai, të hyrat e parapara pritet të jenë 1 miliardë e 264 milionë €, prej të cilave 831 milionë € parashihet të arkëtohen nga doganat, ndërsa nga Administrata Tatimore e Kosovës do të arkëtohen 261 milionë €. Për kategorinë mallra dhe shërbime kuota mbetet pothuaj e njëjtë me atë të vitit të kaluar. Më tej ministri Hamza theksoi se është paraparë zbatimi i vendimit të Qeverisë për rritje pagash, nga i cili vendim përfitojnë mbi 70 mijë punëtorë, kurse duke folur për grandet qeveritare për komunat, vuri në pah se do të arrijnë në 300 milionë €, për vitin 2011.

Sa i përket relacioneve me institucionet ndërkombëtare financiare, ministri përmendi se në qershor të vitit 2010, është nënshkruar programi i parë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe se ky program parashihet 6 (gjashtë) rishikime, që bëhen për faktin se parashikimet nuk realizohen përherë, ashtu siç projektohen.

Bashkëpunimin me ekspertë të Fondit Monetar Ndërkombëtar, ai e vlerësoi shumë të frytshëm dhe vuri në pah se kanë arritur pajtueshmëri për shumicën e linjave buxhetore.

Ministri në fund i ftoi deputetët për miratim në parim të këtij Projektligji.

Kryesuesi - E hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011.

Safete Hadergjonaj - Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, tha se komisioni që ajo e udhëheq e ka shqyrtuar, në parim, Projektbuxhetin për vitin 2011 dhe e ka rekomanduar miratimin në parim.

Shtoi se anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa nga opozita ishin të mendimit që ky Projektligj të mos miratohet në Komision, në parim.

Komision ka vlerësuar se duhet të riformulohet neni 14 i Projektligjit. I paraqiti edhe disa opinione nga diskutimet në Komision për Buxhet dhe Financa dhe shprehu bindjen se disa nga vërejtjet do të inkorporohen në pjesën amendamentuese të Projektligjit.

Në fund ftoi deputetët për miratim në parim të këtij Projektligji.

Adem Grabovci - Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, shprehu bindjen se Projektligji për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011, i respekton prioritetet kryesore, siç janë: rritja ekonomike, zhvillimi i kapaciteteve institucionale, stabiliteti ekonomik-social dhe rritja e standardit të jetesës.

Grupit Parlamentar të PDK-së, gjithashtu është i bindur se qasja e ofruar në projektimin e këtij projektbuxheti e thekson veçmas komponentin zhvillimor, nëpërmjet të cilit do të nxiten rritja ekonomike, krijimi i vendeve të reja të punës etj.

Grupit Parlamentar të PDK-së, e mbështet projektbuxhetin për vitin 2011 dhe ftoi deputetët për miratim në parim të tij.

Naser Osmani - Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se grupi që ai e përfaqëson, është i mendimit se ky Projektligj është një projekt i bazuar në interesa të ngushta politike, pa koncept zhvillimor dhe si ti tillë e rrezikon stabilitetin financiar të vendit. Shtoi se të hyrat tatimore të projektbuxhetit, 78% të të cilave varen nga doganat, i vlerësoi si tregues jo të mirë për perspektivën e integritimit evropian. Si dobësi të tjera, që e shoqërojnë këtë projektbuxhet, ai i përmendi edhe mospërputhjen me Kornizën afatmesme të shpenzimeve, deficitin buxhetor, mosparashikimin e rritjes së pagave, sipas Qeverisë, për 30, 40 dhe 50%, futjen e nenit 4 në Projektligj, që ka të bëjë me privatizimin e PTK-së etj.

Grupit Parlamentar të LDK-së mendon se ky Projektligj duhet t'i kthehet Qeverisë në rishqyrtim.

Visar Ymeri - Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se vendi ynë ka mungesë të madhe të prodhimit dhe se importi total ka arritur mbi 2 miliardë €, ndërsa eksporti arrin mbi 290 milion €. Vetë numrat e përmendur më lart flasin sa e varur është Kosova nga mallrat që importohen nga jashtë.

I vuri në pah disa tregues që flasin për nivelin e varfërisë dhe të papunësisë në vendin tonë, siç janë: 40% e popullatës në Kosovë sot jetojnë me jo më shumë se 1.8 € në ditë, 18% e popullatës në Kosovë nuk i kanë as 0,92 € në ditë për ti shpenzuar. Më tutje ai theksoi se Projektbuxheti i vitit 2011, nuk është buxhet zhvillimor, por është një përsëritje e asaj që po e jetojmë sot dhe asaj që e jetuam dje. Ai e kundërshtoi futjen e nenit 4 për privatizimin e PTK-së, në Projektligjin për buxhetin, që është në kundërshtim me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe se Qeveria më parë për një gjë të tillë duhet ta ketë miratimin e Kuvendit.

Ardian Gjini - Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e citoi ministrin Hamza në lidhje me një pjesë të buxhetit, rreth 300 milionë, që do të mbushen me anë të transferit të aksioneve të aseteve publike në asete private. Ai tha se më mirë do të ishte të thuhet se këto mjete parashihen nga privatizimi i PTK-së. Në bazë të kësaj konstatoi, se kultura e punës së kësaj Qeverie është e njëjtë me atë të Qeverisë së kaluar. Shtroi pyetjen se me cilat metoda mund të realizohet rritja prej rreth 130 milionë € për të hyra shtesë doganore.

U ndal në shpenzimet infrastrukturore, duke i përmendur mjetet e ndara për ndërtimin e rrugës Komoran – Carralevë, si në vitin 2008, në vitin 2009, por edhe në vitin 2011. Gjithashtu e vuri në pah fondin e vogël për subvencione në bujqësi, për të cilin tha se është më i vogël se sa shpenzimet për vetura.

Ibrahim Makolli - Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, tha se grupi që ai e përfaqëson e mbështet në parim Projektligjin për buxhetin për vitin 2011, dhe i vuri në pah tri komponentë të këtij Projektligji: rritjen e pagave, investimet kapitale dhe zvogëlimin e kategorisë së mallrave dhe të shërbimeve.

Sasha Rashiq - Në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se si grup parlamentar e mbështesim Projektligjin për buxhetin për vitin 2011 dhe se do ta japin kontributin e tyre në komisionet parlamentare.

Enis Kervan - Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, tha se si grup parlamentar e mbështesim Projektligjin për buxhetin për vitin 2011 dhe insistoi që ndarjet buxhetore të fokusohen në aspektet, që i japin prioritet zhvillimit ekonomik.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Projektligj i dhanë këta deputetë: Berat Buzhala, Ismet Beqiri, ministri Bajram Rexhepi, kryeministri Hashim Thaçi, ministri Fehmi Mujota, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Blerim Shala, ministri Besim Beqaj, Donika Kadaj – Bujupi, Myzejene Selmani, Shaip Muja, Bahri Thaçi, Rexhep Selimi, Time Kadrijaj, Fikrim Damka, Teuta Sahatçija, Albin Kurti, Kimete Bajraktari, Ministri Ramë Buja, Muhamet Mustafa, Fadil Demaku, Rita Hajzeraj-Beqaj, Agim Kuleta, Xhevdet Neziraj, Armend Zemaj, Idriz Vehapi, Arben Gashi, Albana Fetoshi, Alma Lama, Burim Ramadani, Bekim Haxhiu, Imri Ahmeti, Florin Krasniqi, Latif Gashi, Arsim Bajrami, Eqrem Kryeziu, Liburn Aliu, Teuta Haxhiu, Valbona Dibra, Ali Sadriu, Afrim Kasolli, Duda Balje, Hydajet Hyseni, Sali Morina, Aurora Bakalli, Gëzim Kelmendi, Nazane Breca, ministri Ferid Agani, Ramë Vataj, Hykmete Bajrami, Sala Berisha – Shala, Anton Çuni, Nijazi Idrizi, Sali Asllanaj, Vjollca Krasniqi, Afërdita Berisha – Shaqiri, Salihe Mustafa, ministri Blerand Stavileci dhe në fund ministri Bedri Hamza. Fjalën e tyre e kanë deponuar me shkrim deputetët: Ilmi Reçica, Latif Gashi, Ramiz Lladrovci, Hasime Krasniqi, Lumnije Morina dhe Blerta Deli-Kodra. Diskutimet e plota janë dhënë në transkript, që është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij Projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 67,

Kundër-----35,

Abstenime----- 2.

Kryetari - Konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011.

Kuvendi i ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian ta shqyrtojnë këtë Projektligj brenda një afati, sa më shpejt që është e mundur dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

3. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Komisionin Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave

Kryetari – E njoftoi Kuvendin se Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, e ka shqyrtuar Propozimvendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për emërimin e anëtarëve në Komisionin Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E Hapi diskutimin për shqyrtimin e emërimit të anëtarëve në Komisionin Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, dhanë: në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës: ministri Mahir Yagcilar, në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Idriz

Vehapi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Afrim Hoti, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Ibrahim Makolli, si dhe deputetët: Sabri Hamiti dhe Ismet Beqiri, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Propozimvendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për emërimin e anëtarëve në Komisionin Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 63,
Kundër ----- 24,
Abstenime -----15.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Komisionit Qendror të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave

I. Anëtarë të Bordit të Komisionit Qendror të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, emërohen:

1. Rifat Blaku,	Zyra e Kryeministrit, kryesues,
2. Naim Fetahu,	Ministria e Administratës Publike, anëtar,
3. Sanije Himaj,	Ministria e Ekonomisë dhe Financave, anëtare,
4. Hakile Xhaferi,	Ministria e Bujqësisë, anëtare,
5. Besnik Osmani,	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar,
6. Shkumbin Kastrati,	Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar,
7. Fitim Gllareva,	Ministria e Punëve të Jashtme, anëtar;
8. Murat Meha,	Agjencia Kadastrale e Kosovës, anëtar,
9. Gazamend Çitaku,	Ministria e Drejtësisë, anëtar,
10. Isa Ukella,	Ministria për Komunitete dhe Kthim, anëtar,
11. Ibrahim Shabani,	Enti i Statistikave të Kosovës, anëtar,
12. Johan Axander,	Zyra Civile Ndërkombëtare, anëtar,
13. Karin Marmsoler,	Komisioni Evropian, anëtar,
14. Nebojsa Azdenkoviç,	Komuniteti serb, anëtar;
15. Fikrim Damka,	Komunitetet tjera në Kosovë, anëtar,
16. Mark Krasniqi,	Akademia e Shkencave dhe Arteve, anëtar;
17. Burim Ejupi,	Shoqëria Civile, anëtar.

II. Mandati i të emëruarve nga pika **I.** e këtij vendimi zgjat deri më 31 dhjetor 2011.

Kryetari - E deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare në orën 20: 40 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale